

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Nr. 08-1597/2

27.06.2024

K ë r ç o v ë

PROCESVERBAL

Nga seanca e 35-të e Këshillit të Komunës së Kërçovës, e mbajtur më datë 27.06.2024 në hapsirat e Këshillit të Komunës së Kërçovës me fillim në ora 10 .

Seancën e hapi dhe me të udhëhoq kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës Skender Xhabiri, ndërsa të pranishëm ishin këshilltarët: Kamerr Klosi, Drenuse Dalipi, Filip Mitreski, Mihajlo Daniloski, Violeta Spasenoska, Laze Jaqimoski, , Olgica Poposka, Igor Stojanoski, Daniela Poposka, Anto Trajanoski, Tefik Lutfiu, Valentina Llazaroska, Ivanço Bozhinoski, Viktor Aleksoski, Ramazan Zulbeari, Fortesa Sejdini, Sibel Tufkegji dhe Agim Sadiku, Abdulla Sejdini, Argjent Asani, Valbona Adili Emini.

Në mungesë ishën këshilltarët: Migjen Zendeli.

Në seancë morrën pjesë: Aneta Nasteska –Sekretare e komunës, Valdet Selimi, Burim Kadriu, Emin Nasufi, Valbon Mehmedi, Fjolla Aliu dhe Florika Manakoska Cvetanoska-përfaqësues nga administrata lokale, përfaqësues nga NK „ Komunalec,, dhe Gazetarë nga Tv „Uskana,, përfaqësues nga SHF „Vladimir Polezhinoski,, dhe drejtorët nga: SHF „Kuzman Josifoski Pitu,, Kërçovë, SHF „Sande Shterjoski,, Kërçovë, SHF „Hristo Uzunov,, f.Drugovë, SHF „Gj.K Skenderbeu,, f.Sërbicë, SHF "Milto Gurra" f. Strellcë, SHF „Naim Frashëri,, f.Jagoll dhe banorë nga f.Osoj.

Kryetari i këshillit pyeti nëse dikush ka ndonjë vërejtje për Procesverbalin nga seanca e 34-të e mbajtur më datë 30.05.2024.

Agim Sadiku- bën me dije se ka vërejtje për përkthimin nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe të procesverbalit paraprak.

Kryetari i këshillit theksoi se vërejtja është në rregull dhe kërkoi që t'i kushtohet më shumë vëmendje përkthimeve të dokumenteve zyrtare.

Përshkak se askush tjetër nuk e morri fjalën Kryetari i Këshillit e vendosi për miratim Procesverbalin nga seanca e 34-të e këshillit, e mbajtur më datë 30.05.2024, dhe i njejt i miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (nuk ka), PËRMBAJTUR (nuk ka).

Kryetari i këshillit për këtë seancë propozoi rendin e ditës si vijojn:

R E N D I I D I T Ë S

1. Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2024 (ridestinin).

2. Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Programit për rregullimin e tokës ndërtimore për hapsirën e Komunës së Kërçovës për vitin 2024.

3. Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë.

4. Propozim Plan vjetorë për punësim për vitin 2025 në SHF „Vladimir Polezhinoski,,

5. Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Sande Shterjoski” Kërçovë.

6. Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Hristo Uzunov” f. Drugovë.

7. Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “GJ.K. Skenderbeu” f. Sërbicë.

8. Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Milto Gurra” f. Strellcë.

9. Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Naim Frasheri” f. Jagoll

10. Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të NP “Komunalec” Kërçovë.

11. Propozim Vendimi për dhurimin e kompjuterëve pronë të Komunës së Kërçovës shkollave fillore dhe të mesme.

12. Propozim vendimi për shpërblimin e nxënësve për rezultatet e arritura në gara në nivel shtetërorë.

13. Propozim Vendimi për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për formimin të këshillit lokal për preventivë.

14. Propozim Vendimi për dhënien në shfrytzimit të objektit pronë e Komunës së Kërçovës, Ndërrmarrjes Publike “Komunalec” Kërçovë.

15. Propozim Vendimi për zgjatjen e orarit të punës të objekteve afariste në teritorin e Komunës së Kërçovës.

16. Propozim vendimi për emrimin e antarit në Këshilli e Shkolës SH.F “Hristo Uzunov” fsh.Dërgovë

17. Të ndryshme!

Kryetari i Këshillit Skender Xhabiri, pasi e lexoi rendin e ditës, hapi diskutim:

Këshilltari Mihajlo Daniloski e mori fjalën dhe kërkoi që pika e parë Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2024 (ridestinin), të tërhiqet nga rendi i ditës për shkak se këshilltarët nuk kanë informata të mjaftueshme për të.

Këshilltari Laze Jaqimoski gjithashtu kërkoi shtyerjen e pikës së dytë dhe të 16-të të Rendit të ditës, përshkak se këshilltarët nuk kishin informacione të mjaftueshme për to. Ai theksoi se për pikën 16 nuk është mbajtur Komisioni për Çështje Mandatare, Zgjedhje dhe Emërime.

Kryetari i këshillit theksoi se problemi është se këshilltarët nuk vijnë në mbledhje edhe pse janë ftuar siç duhet, ai theksoi se rendi i ditës nuk duhet të ndryshohet, pra të mbetet i njëjtë.

Këshilltari Laze Jaqimoski pyeti se kush do t'i bëjë propozimet për anëtarë, në lidhje me pikat 13 dhe 16, sepse në mbledhjen e Komisionit për çështje mandatare, zgjedhje dhe emërime, nuk ishte i pranishëm as kryetari i komisionit, Ivanço Bozhinoski.

Kryetari i këshillit informoi se propozimet për anëtarë do të propozohen nga vetë këshilltarët në seancë.

Agim Sadiku- po ashtu ka theksuar se pikat duhet të shtyhen.

Kryetari i Këshillit e vendosi në votim propozimin e këshilltarit Mihajlo Daniloski për tërheqjen e pikës së parë nga rendi i ditës dhe nuk u miratua me 9 vota PËR, 13 vota KUNDËR dhe PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit konstatoi se kjo pikë mbetet në rend dite.

Kryetari i këshillit e vendosi në votim propozimin e këshilltarit Laze Jaqimovski për tërheqjen e pikave 13 dhe 16 nga rendi i ditës dhe nuk u miratua me 9 vota PËR, 13 vota KUNDËR dhe PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit theksoi se pikat mbeten dhe se këshilli fillon me punë sipas rendit të ditës.

Kryetari i Këshillit Skender Xhabiri hapi diskutim.

1. PIKA E PARË: Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2024 (ridestinin).

Burim Kadriu – shpjegoi nevojat që ka Komuna e Kërçovës për plotësimin dhe ndryshimin e Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2024 dhe i arsyetoi ato. Në vetë Propozim Vendimin, i cili është propozuar në rendin e ditës, propozohet si vijon: Nga zëri 482930 të minusohen 1.212.000. Nga zëri 421110 Programi J3 të minusohen 1,000,000,00. Nga programi P10 të minusohen 200,000,00. Në programin K4 nënzëri 424990 të minusohen 300.000,00 denarë.. Gjithashtu, të minusohen mjete nga zëri 425640 programi F10 në vlerë prej 122.000,00.

Ai propozoi gjithashtu një rritje të mjeteve në Programin JMA nënzëri 425940 në vlerë prej 152,000, rritje të mjeteve në Programin EA0 nënzëri 482920 në vlerë prej 122,000. Po ashtu, Propozim-Vendimi ndryshohet me kërkesë të SHF „Kuzman J. Pitu” për shkak të projekteve nga Erasmus+, gjegjësisht ndryshohen zërat nga llogaritë e Donacioneve. Në programin H1 nënzëri 420120 në vlerë prej 30.750,00 në nënzërin 420220 minusohen mjete në vlerë prej 32.250,00. Zvogëlohen mjete nga nënzëri 425990 në vlerë prej 570.400,00 denarë.Gjithashtu minusohen mjete nga nënzëri 464990 në vlerë prej 52.000,00 denarë. Rriten nënzërat 420210 në vlerë prej 342.700,00 dhe nënzëri 420320 në vlerë prej 342.700,00.

Agim Sadiku- kërkoi nga përfaqësuesi i komunës që të sqarojë se cilat projekte janë planifikuar që të realizohen dhe cilat janë anuluar dhe tani ku po rrimërohen ato projekte, pra ku do të ridestionhen mjetet?

Burim Kadriu - Ai ka shpjeguar se nuk do të ketë shkurtime të projekteve. Ai theksoi se në Komunën e Kërçovës mjetet për projektet janë siguruar përmes tenderëve publikë dhe projektin e fitojnë ata që kanë ofertën më të ulët.

Agim Sadiku - Ai pyeti se pse është ulur shuma, kur projektet nuk janë realizuar. Ai po ashtu pyeti nëse projekti Biçincë - Mahmude është përfunduar dhe realizuar. Ai theksoi se është e nevojshme që të mbahen komisionet që këshilltarët të shohin numrat dhe ndryshimet e buxhetit për të kuptuar se ku shkojnë paratë. Ai ka theksuar se si këshilltarët kanë dilemë nëse projektet janë realizuar apo jo.

Laze Jaqomoski - Ai informon se dëshiron të dijë njëjtë si këshilltari Agim Sadiku se cilat projekte nuk do të realizohen.

Burim Kadriu- përsëriti se nuk do të ketë reduktim të projekteve dhe sqaroi se përgjigjen e ka shpjeguar në vetë prezantimin.

Kryetari i këshillit e vendosi në votim Propozim Vendimin për ndryshim dhe plotësim të Buxhetit të Komunës së Kërçovës për vitin 2024 (ridestinin) dhe i njëjti u miratua me 13 vota PËR, KUNDËR (asnjë), 8 vota PËRMBAJTUR.

2. PIKA E DYTË: Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Programit për rregullimin e tokës ndërtimore për hapsirën e Komunës së Kërçovës për vitin 2024.

Valbon Mehmedi ka shpjeguar Propozim-Vendimin.

Agim Sadiku – e morri fjalën dhe përshëndeti vendimin për rregullimin e Tokës Ndërtimore. Ai ka theksuar se nuk është kundër këtij propozimi, por dyshon për keqpërdorime në rregullimin e tokës publike për shkak të mungesës së fakteve për të njëjtën gjë. Qëllimi i këtij Propozim-Vendimi është që të ketë më shumë investime kapitale.

Kryetari i këshillit e vuri në votim Propozim Vendim për ndryshim dhe plotësim të Programit për rregullimin e tokës ndërtimore për hapsirën e Komunës së Kërçovës për vitin 2024 dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

Kryetari i këshillit hapi debat për pikën e tretë.

Për shkak të vonesës së përfaqësuesit nga shkolla Kuzman Josifoski Pitu dhe pamundësisë për të sqaruar pikën, Kryetari i këshillit hapi debat për pikën 4.

4. PIKA E KATËRT: Propozim Plan vjetorë për punësim për vitin 2025 në SHF „Vladimir Polezhinoski,,

Përfaqësuesi i shkollës shpjegoi planin vjetor të punësimit dhe theksoi se në shkollë janë paraparë tre vende pune, dy higjenistë dhe një rojtarë.

Kryetari i këshillit e vuri në votim Propozim Plan vjetorë për punësim për vitin 2025 në SHF „Vladimir Polezhinoski,, Kërçovë dhe i njehti u miratua me 13 vota PËR, KUNDËR (asnjë), 8 vota PËRMBAJTUR.

Kryetari i këshillit dha një pushim prej 5 minutash që të vijjnë drejtorët e shkollave dhe i paralajmëroi për vonesën dhe dorëzimin në kohë të materialeve nga shkollat.

Pas pushimit u kalua në:

3. PIKA E TRETË: Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë.

Drejtori i “Kuzman Josifoski-Pitu”- E sqaroi planin për punësim. Në planin e tyre për vitin 2025, nga stafi i tze teknik do të dilnin në pension katër punonjës dhe kërkoi miratimin për katër punësime të reja.

Kryetari i këshillit e vuri në votim Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Kuzman Josifoski Pitu” Kërçovë dhe u miratua me 21 vota PËR, KUNDËR (asnjë),PËRMBAJTUR (nuk ka)

5. PIKA E PESTË: Propozim plani vjetor i punësimit për vitin 2025 në “Sande Shterjoski” Kërçovë.

Drejtori i shkollës shpjegoi planin dhe informoi se kanë nevojë për një punësim të ri, sekretar Teknik.

Kryetari i këshillit e vendosi në votim Propozim planin vjetor për punësim për vitin 2025 për SHF “Sande Shterjoski” Kërçovë, i cili u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë)

6. PIKA E GJASHTË: Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Hristo Uzunov” f.Drugovë.

Drejtori i shkollës theksoi se kanë nevojë për dy punësime të reja.

Kryetari i këshillit e vuri në votim Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Hristo Uzunov” f.Drugovë, dhe i njëjti u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë).PËRMBAJTUR (asnjë)

7. PIKA E SHTATË: Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “GJ.K.Skenderbeu” f.Sërbicë.

Drejtori i shkollës shpjegoi planin e tyre vjetor të punësimit në të cilin ata po planifikojnë tre punësime të reja.

Kryetari i këshillit e hodhi në votim Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “GJ.K.Skenderbeu” f.Sërbicë dhe u miratua me 22 vota PËR,KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

8. PIKA E TETË: Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Mילו Gurra” f.Strellcë.

Përfaqësuesi i shkollës shpjegoi planin e tyre dhe informoi se shkolla ka nevojë për një punësim të ri - arkivist.

Kryetari i këshillit e hodhi në votim Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Mילו Gurra” f.Strellcë dhe u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

9. PIKA E NËNTË: Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Naim Frasheri” f.Jagoll .

Drejtori i shkollës theksoi se nuk kanë plane për punësime të reja për vitin e ardhshëm.

Kryetari i këshillit e hodhi në votim Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të SHFQ “Naim Frasheri” f.Jagoll dhe u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë)

10. PIKA E DHJETË: Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të NP “Komunalec” Kërçovë.

Proceduralisht fjalën e morri këshilltari Laze Jaqimovski, i cili e pyeti përfaqësuesin e Këshillit Komunal nëse kanë marrë kërkesë nga banorët e fshatit Osoj. Këshilltari gjithashtu kërkoi nga përfaqësuesin e Komunalecit që të qëndrojë deri në përfundim të seancës në mënyrë që të mund të shqyrtohet Kërkesa nga fshatarët e f.Osoj në pikën „Të ndryshme„ të cilët për një kohë më të gjatë nuk kanë ujë të pijshëm.

Përfaqësuesi nga “Komunalec” shpjegoi se sa pensione do të pasojnë në vitin 2025 dhe me punësimet e reja planifikojnë të barazojnë numrin. Bëhet fjalë për 39 vende të reja pune.

Kryetari i këshillit e vuri në votim Propozim Plani vjetorë për punësim për vitin 2025 të NP “Komunalec” Kërçovë dhe u miratua me 13 vota PËR, KUNDËR (asnjë), 8 vota PËRMBAJTUR.

11. PIKA E NJËMBËDHJETË: Propozim Vendimi për dhurimin e kompjuterëve pronë të Komunës së Kërçovës shkollave fillore dhe të mesme.

Fjalën e ka sekretarja e Komunës së Kërçovës- Aneta Nasteska e cila theksoi se kompjuterët që janë në gjendje të mirë, komuna e Kërçovës propozon që t'u dhurohen shkollave fillore dhe të mesme.

Këshilltari Agim Sadiku e ka mirëpritur këtë vendim, por ka dyshime për gjendjen e kompjuterëve. Duke pasur parasysh se teknologjitë përparojnë çdo ditë, ai dyshon se kompjuterët do të jenë adekuat për shkollat.

Në këtë pyetje, sekretari i Komunës së Kërçovës është përgjigjur se ekspertët nga lëmia e informatikës të cilët janë të punësuar në komunë i kanë kontrolluar dhe kanë vendosur që kompjuterët janë në gjendje të mirë. Do të ishte mirë që ato të përdoren në shkolla për kryerjen e punëve administrative.

Kryetari i Këshillit e vuri në votim Propozim Vendimin për dhurimin e kompjuterëve pronë të Komunës së Kërçovës shkollave fillore dhe të mesme dhe u miratua me 22 vota për. KUNDËR (asnjë) ABSTENDER (asnjë).

12. PIKA E DYMBËDHJETË: Propozim vendimi për shpërblimin e nxënësve për rezultatet e arritura në gara në nivel shtetërorë.

Sekretarja e komunës, Aneta Nasteskaa, informon se Komuna e Kërçovës propozon që nxënësit që kanë fituar çmim shtetëror gjatë vitit të kaluar të shpërblehen. Dhe atë 15 nxënës që fituan vendin e parë në konkurs shtetëror me 10 mijë denarë, 15 nxënës që fituan vendin e dytë me 5 mijë denarë dhe 15 nxënës që fituan vendin e tretë me 3 mijë denarë.

Valentina Lazareska informon se këtë Vendim e ka propozuar grupi këshilltarëve të tyre. Ajo po ashtu ka theksuar se ka një vërejtje për çmimet, gjegjësisht ka shprehur keqardhje për mos shpërblimin e mentorëve. Ajo theksoi se mentorët punojnë shumë me studentët dhe se puna e tyre nuk vlerësohet. Ajo theksoi se në të ardhmen të shpërblehen edhe mentorët njësoj si studentët, me një shumë simbolike.

Sekretarja e Komunës së Kërçovës theksoi se kjo mund të rregullohet në të ardhmen, gjegjësisht paraprakisht të planifikohen mjetet në Buxhetin për vitin 2025.

Laze Jaqimoski theksoi se kjo përsëritet çdo vit dhe sugjeroi që të përfshihet në Propozim buxhet. Ai propozoi që të ketë vetëm një Vendim për të ardhmen.

Agim Sadiku e përshëndeti Propozim-vendimin për shpërblim monetar për studentët, por theksoi se edhe mentorët duhet të shpërblehen dhe vetëm kjo do të rrisë motivimin e tyre për të punuar me studentët.

Kryetari i këshillit e hodhi në votim Propozim vendimi për shpërblimin e nxënësve për rezultatet e arritura në gara në nivel shtetërorë dhe u miratua me 22 vota PËR, KUNDËR (asnjë), PËRMBAJTUR (asnjë).

13. PIKA E TREMBËDHJETË: Propozim Vendimi për ndryshim dhe plotësim të Vendimit për formimin të këshillit lokal për preventivë.

Valdet Selimi shpjegoi nevojën e ekzistimit të një Këshilli Lokal që ndihmon në momentet e krizës dhe kryen parandalime të ndryshme. Për momentin ky këshill ka nevojë për tre anëtarë të rinj. Anëtarët mund të jenë nga çdo kategori qytetarësh. Ai po ashtu ka theksuar se duhet të konsultohet me personat që do të jenë në këtë Këshill, pra nëse do të donin të anëtarësoheshin vullnetarisht.

Sekretari i komunës theksoi se nuk ka asnjë propozim konkret për emra për këshillin.

Agim Sadiku propozoi që të tërhiqet pika për shkak se nuk ka kaluar në komision.

Laze Jaqimoski e morri fjalën, dhe tha se për faktin se askush nuk ka pasur propozime, në fillim të seancës ka kërkuar që kjo pikë të tërhiqet.

Kryetari i këshillit tha se ka biseduar me disa institucione për të dhënë propozimet e tyre, por ende nuk ka marrë përgjigje konkrete prej tyre.

Agim Sadiku propozoi që të mos tërhiqet propozimi, por të miratohet një Konkluzion me të cilin do të propozohen tre persona, pra pas pikës të ketë një konkluzion.

Kryetari i këshillit propozoi që në seancën e ardhshme të sillen propozimet nga institucionet. Ai bëri me dije se anëtarët nuk duhet të jenë pensionistë, sepse kjo punë është vullnetare dhe se personat që do të propozohen vetë do të duhet të punojnë. Propozoi që anëtarët të jenë nga të punësuarit e Komunës së Kërçovës dhe NK Komunalecit.

14. PIKA E KATËRMBËDHJETË: Propozim Vendimi për dhënien në shfrytzimit të objektit pronë e Komunës së Kërçovës, Ndërrmarrjes Publike “Komunalec” Kërçovë.

Aneta Nasteska e shpjegoi Propozim Vendimin.

Kryetari i këshillit e vuri në votim Propozim Vendimi për dhënien në shfrytzimit të objektit pronë e Komunës së Kërçovës, Ndërrmarrjes Publike “Komunalec” Kërçovë dhe e njëjta u miratua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (asnjë).

15. PIKA E PESËMBËDHJETË: Propozim Vendimi për zgjatjen e orarit të punës të objekteve afariste në teritorin e Komunës së Kërçovës.

Sekretari i komunës e shpjegoi Propozim Vendimin.

Kryetari i këshillit e vuri për miratim Propozim Vendimi për zgjatjen e orarit të punës të objekteve afariste në teritorin e Komunës së Kërçovës dhe i njëjti u votua me 22 vota PËR. KUNDËR (asnjë). PËRMBAJTUR (nuk ka).

16. PIKA E GJASHTËMBËDHJETË Propozim vendimi për emrimin e antarit në Këshillin e Shkolës SH.F “Hristo Uzunov” fsh.Dërgovë.

Kryetari i Këshillit hapi diskutim.

Ivanço Bozhinoski, si kryetar i Komisionit për mandate, zgjedhje dhe emërimë, informon se seanca e Komisionit nuk është mbajtur dhe për anëtare të Këshillit të shkollës ka propozuar Aneta Sarxhoskën.

Emin Nasufi – Informon se gjithashtu propozon Aneta Sarxhoskën.

Laze Jaqimoski i bëri një pyetje Emin Nasufit se kush e propozoi atë person?

Emin Nasufi – Informon se personi është propozuar nga Komuna e Kërçovës.

Laze Jaqimovski bëri vërejtje se në Komisionin e paraparë për mandate, zgjedhje dhe emërimë askush nuk ka ardhur dhe se vetëm ai ka qenë i pranishëm. Ai theksoi se nuk ndiqet asnjë procedurë dhe se propozime të tilla ishin arbitrare. Dhe se propozimet për zgjedhjen e anëtarit nuk duhet të jepen direkt në seancë, sepse ekziston një komision për këtë. Ai theksoi se komisionet duhet të mbahen dhe të punojnë.

Emin Nasufi - Ai ka theksuar se nuk është përgjegjës për punën e Komisioneve dhe se mund të jetë përgjegjës vetëm për Sektorin e Arsimit.

Laze Jaqimoski theksoi se Ivanço Bozhinoski nuk ka marrë pjesë në komision dhe se nuk ka të drejtë të bëjë propozim për anëtar në cilësinë e kryetarit.

Ivanço Bozhinoski tha se nuk është kuptuar mirë dhe se anëtarin nuk e propozon për kryetar të komisionit por për këshilltar.

Valentina Lazareska për anëtarë e sugjeroi Mihajlo Danilloskin, për të cilin tha se është cilësor dhe kompetent për atë pozitë. Kompetent është pasi me vendbanim është në f.Dërgovë.

Kryetari i këshillit e vuri në votim propozimin që Aneta Sarxhoska të jetë anëtare e Këshillit shkollor dhe i njejt i miratua me 12 vota PËR, 6 vota KUNDËR dhe 3 vota PËRMBAJTUR.

Edhe pse këshilltari Laze Jaqimoski propozoi që kandidati tjetër të hidhet në votim, kryetari i Këshillit theksoi se një anëtar tashmë është zgjedhur dhe se nuk ka nevojë për votim tjetër.

17. Të ndryshme.

Një grup qytetarësh nga fshati Osoj kanë dorëzuar një njoftim në Ndërmarrjen Publike “Komunalec” se nuk kanë ujë të pijshëm për gati një muaj të tërë. Për shkak të gjendjes alarmante në takimin e sotëm kanë marrë pjesë tre banorë nga fshati “Osoj”.

Laze Jaqimoski - Theksoi se gjatë seancës ka kërkuar nga përfaqësuesi i NK “Komunalec” që të qëndrojë dhe ta sqarojë situatën, por ai është larguar. Ai bën me dije se banorët e fshatit Osoj nuk kanë pasur ujë të pijshëm për gati një muaj të tërë, përkatësisht ndodhen në një vendbanim periferik të qytetit, gjë që sot është e

paimagjinueshme. Ai theksoi se komuna është themeluese e Ndërmarrjes Publike "Komunalec" dhe se duhet t'i urdhërojë që ta rregullojnë problemin.

Kryetari i këshillit njofton se përfaqësuesi i NK "Komunalec" është larguar dhe ata si Këshill i Kërçovës nuk janë të njohur me gjendjen në terren. Ai theksoi se do ta njoftojnë përfaqësuesin e NK "Komunalec" përmes organeve komunale. Bëhet me dije se Kërkesa nga banorët do t'i dërgohet Shërbimit Publik, "Komunalec".

Nga banorët e pranishëm të fshatit Osoj, fjalën e morri Sinisha Trpeski, i cili theksoi se banorët tashmë kanë qenë në NK "Komunalec" dhe se ndërmarrja nuk i është përgjigjur kërkesës së tyre.

Kryetari i këshillit njofton banorët se Këshilli do ta përcjellë kërkesën e tyre në Ndërmarrjen Publike "Komunalec".

Meqenëse askush tjetër nuk e morri fjalën, dhe kështu u shterë rendi i ditës për këtë seancë, Kryetari i Këshillit të Komunës së Kërçovës e mbylli seancën e Këshillit në ora 12:10 minuta.

Procesverbalist

-Florika Manakoska

Këshilli i Komunës së Kërçovës
Kryetar
Skender Xhabiri d.v.

Përkthyes:Tefik Asani

